



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.03.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Tryezë konsultimi për projektligjin “Për nismën ligjvënëse të shtetasve në Republikën e Shqipërisë”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Damian Gjikhuri, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Adnor Shameti, Elena Xhina, Jyrgis Çyrbja, Spartak Braho dhe Edlira Bode

Mungojnë:

Edmond Leka, Tom Doshi

Të ftuar:

Edvin Kukunja - këshilltar i ministrit të Drejtësisë

Eljona Bylykbashi - përgjegjëse e Sektorit të Reformave Ligjore dhe Përafrimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Katrina Treska – Drejtoreshë e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë

Besnik Dervishi – Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Robert Gajda – Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

Aurela Anastasi – përfaqësuese nga shoqëria civile

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përhëndetje, të gjithëve!

Sot do të organizojmë një tryezë të konsultimit publik për një projektligj shumë të rëndësishëm “Për nismën ligjvënese të shtetasve në Republikën e Shqipërisë”. Ky projektligj, që është në tryezën e punës së Kuvendit të Shqipërisë dhe të Komisionit të Ligjeve, është faza e dytë e konsultimit publik pas ardhjes së opinionit të Komisionit të Venecies. Komisioni i Ligjeve e dërgoi këtë projektligj të rëndësishëm me vendim për të marrë një opinion të specializuar në Komisionin e Venecies. Patëm një vizitë shumë të rëndësishme dhe të suksesshme të delegacionit të Komisionit të Venecies në Tiranë, ku u takuan me anëtarët e Komisionit të Ligjeve, me nismëtarin, me relatorin, por edhe me një grup të kolegëve të mi deputetë për opinionet tona për këtë projektligj të rëndësishëm, që gjithsesi ka nevojë, para se ta kalojmë në Komisionin e Ligjeve dhe më pas në seancë plenare, edhe për një tryezë të fundit të konsultimit publik, për të reflektuar për sugjerimet që ka dhënë Komisioni i Venecies në tekstin e projektligjit.

Para se t’ia kaloj fjalën zonjës Hysi dhe më pas relatorit, zotit Gjijnuri, dua të them se, në takimin që kemi pasur me delegacionin e Komisionit të Venecies, është sugjeruar të kemi një ligj të thjeshtë. Pra, sot e kemi të definuar në Kushtetutë nismën ligjvënese. Nuk kemi pasur një ligj të posaçëm dhe të themi të drejtën, në variantin e parë të projektligjit, kur e kam lexuar dhe e kemi diskutuar me anëtarët e Komisionit të Venecies, nuk e kuptoja. Duhet ta zbërthejmë me një gjuhë shumë të thjeshtë në ligj atë që ka thënë Kushtetuta. Nisma ligjvënese është e Këshillit të Ministrave, e çdo deputeti dhe e 20 mijë zgjedhësve. Ka pasur nisma qytetarësh edhe pa këtë ligj, por shpresoj që grupi i punës të ketë sjellë variantin final që duhet të këtij projektligji pas opinionit të Komisionit të Venecias. Unë e mirëpres dhe e përshëndes organizimin e kësaj tryeze, si dhe angazhimin e aktorëve dhe faktorëve të shoqërisë civile me ndihmën dhe kontributin që kanë dhënë, qoftë në hartimin apo draftimin e variantit fillestar të ligjit, edhe në tekstin integral që kemi sot në ligj. Nuk e di nëse kanë ardhur përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë. Ka përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka.

Zakonisht, kur është nismë deputeti, Ministria e Drejtësisë i sjell opinionet me shkrim, por sot duhet të kishte ardhur dikush si përfaqësues.

Prezenca e OSBE-së në Tiranë ka konfirmuar pjesëmarrjen e dy përfaqësuesve, të cilët i kemi sot këtu me status vëzhguesi.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është zonja Pasko, drejtoreshë Juridike. Gjithashtu, Avokati i Popullit, Enio Haxhimihali është prezent sot, drejtori i Kabinetit dhe Erjona Canaj, komisionere nga seksioni i administratës, komisionieri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zoti Dervishi, është prezent dhe komisionieri zoti Gajda, për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nga kolegji universitar “Luarasi” ka të pranishëm?

Nga fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” është prezent zonja Ersida Sefa. Kemi prezent edhe profesoreshën e nderuar, zonjën Anastasi, që ka dhënë një kontribut të pamohueshëm në draftimin e kësaj nisme ligjore. Nga koalicioni “Drejtësi për të gjithë” është përfaqësues zoti Astrit Bajo dhe nga koalicioni “Vëzhgues dhe vendorë” kanë konfirmuar pjesëmarrjen, por nuk kanë ardhur.

Gjithsesi, pa humbur kohë, do t’ia kaloj fjalën koleges sime, zonjës Hysi dhe më pas relatorit. Ju lutem, shkurtimisht, të gjithë, sepse kjo është mbledhje pune dhe po regjistrohet për efekt të dokumentimit parlamentar të kësaj tryeze. Do të doja të ishte më tepër mbledhje pune. Kemi një draft të integruar mbi tavolinë dhe pas kësaj tryeze të konsultimit publik, këshilltarët e komisionit të mbajnë shënim çdo sugjerim që do të bëhet nga të pranishmit dhe të kemi një draft final, që sipas kalendarit, ta fusim në axhendën e komisionit.

Fjala për ju, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, të gjithë pjesëmarrësve!

Projektligji “Për nismën ligjvënëse të shtetasve në Republikën e Shqipërisë” është prezantuar në Komisionin e Ligjeve dhe ka pasur edhe një kërkesë për ta përcjellë në Komisionin e Venecies. Sikurse e tha edhe kryetari i komisionit, ka pasur një komunikim intensiv me Komisionin e Venecies, jo vetëm që një delegacion i komisionit ka qenë në Shqipëri, por njëkohësisht ne ishim të ftuar si miq special për të dëgjuar dhe ndjekur nga afër punimet atje. Njëkohësisht ju përpara keni opinionin e përkthyer zyrtarisht në gjuhën shqipe. Nisma është përgatitur nga shoqëria civile, por nga fakti që ne nuk e kemi ligjin që do të lehtësonte procedurën e depozitimit të kësaj nisme, u mor dhe u prezantua nga dy deputetë.

Nga momenti që ka ardhur opinionin e Komisionit të Venecies deri më sot është bërë një punë teknike, ku janë marrë një për një të gjitha komentet dhe sugjerimet e Komisionit të Venecies dhe janë hedhur në një tabelë, të cilën besoj se këshilltarja e komisionit jua ka përcjellë. Ky është një dokument pune dhe uroj ta keni studiuar. Kam besim që mund të

përmirësohet me mendimet dhe sugjerimet që do të jepni për të pasur një ligj sa më të mirë dhe të mos i rikthehemi rishikimit të mendimit të tij në një kohë shumë të shkurtër.

Komisioni i Venecies kishte një sugjerim shumë praktik. Kërkesa e parë ishte të thjeshtohet procedura që çon në paraqitjen e një nisme të shtetasve. Kërkesa e dytë e Komisionit të Venecies ka qenë për të bërë dallimin midis nismës së zgjedhësve dhe rastet e petitionit. Në fakt, ka qenë një lapsus në një nen, pasi peticioni nuk shqyrtohet fare dhe nuk ka nevojë për një procedurë kaq të gjatë. Pra, ne kemi rënë dakord që kjo gjë mund të adresohet shumë mirë.

Së treti, Komisioni i Venecies ka bërë një rekomandim për sa i përket mënyrës së mbledhjes së firmave, vendit të mbledhjes së firmave, si dhe angazhimet që duhet të kenë organet e qeverisjes vendore, por edhe angazhimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në këtë rast ne e kemi vlerësuar të drejtë që duhet të merrnim opinionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, megjithëse zonja Anastasi e ka konfirmuar disa herë, që ka pasur në të gjitha tryezat e konsultimeve mendim të përfaqësuesve të KQZ-së. Në kuadër të grupit të punës ka pasur një kontribut me vlerë nga përfaqësuesit e KQZ-së.

Gjithashtu, Komisioni i Venecies dhe ODIHR-i, duke qenë se kanë pasur një opinion të përbashkët, kanë rekomanduar që të thjeshtësojnë kërkesat për vendet e mbledhjes së firmave, të cilat jo detyrimisht duhet të jenë në vende publike. Një çështje tjetër e diskutueshme ka qenë edhe ajo e shkrimeve online, për të cilat ne kemi një ligj për nënshkrimin elektronik, por që deri më sot ju e dini se sa e vështirë ka qenë për t'u zbatuar.

Komisioni i Venecies dhe ODIHR-i e kanë vlerësuar këtë nismë si një ndër nismat e avancuara në vendet e rajonit dhe më gjerë dhe do ta ndjekin me vëmendje miratimin dhe zbatimin e këtij ligji, duke shprehur gatishmërinë për të na mbështetur për të krijuar një përvojë shumë të mirë, e cila më pas mund të përdoret edhe në vendet e tjera. Duhet ta pranojmë të gjithë që kjo është një nismë delikate, e cila kërkon një pjekuri nga të gjithë qytetarët që mund të paraqesin nisma, si dhe kërkon një edukim ligjor shumë të mirë të tyre.

Nga ana tjetër, Komisioni i Venecies dhe ODIHR-i kanë rekomanduar që në këtë proces të shqyrtimit të projektligjit dhe mundësisë së rishikimit të tij, të kemi parasysh edhe transparencën e financimit të nismave dhe bërjen publike të tyre, me qëllim që të shmangen nisma, të cilat mund të jenë jo shprehje e lirë e vullnetit të zgjedhësve, ose për të cilat Kuvendi mund të vihet në një pozitive disi delikate. Ka pasur një diskutim për rolin e Kuvendit të Shqipërisë nëse mund të rregullohet me ligj ose jo. Në diskutimin që kemi pasur me zonjën Anastasi dhe me grupin e punës kemi thënë se Kuvendi ka rregulloren e tij dhe ne jemi në momentin kur Rregullorja e Kuvendi është në proces përmirësimi. Në këtë kuadër mund të ketë

hapësira për të bërë ndonjë ndryshim, nëse ju e vlerësoni se duhen bërë ndryshime të tilla, dhe kjo vjen si sugjerim.

Gjithashtu, Komisioni i Venecies dhe ODIHR-i rekomandojnë që duhet të jemi të kujdesshëm për sa i përket detyrimit që i vihet Kuvendit të Shqipërisë për të miratuar nismat e 20 mijë zgjedhësve. Në fakt, çdo deputet ka të drejtën dhe lirinë e tij ta votojë ose jo një nismë, por Komisioni i Venecies dhe ODIHR-i rekomandojnë që motivi i refuzimit të një nisme, të paktën kur vjen për arsye thelbësore, t'u lihet anëtarëve të parlamentit dhe jo të vendoset me votim në parlament, me qëllim që vullneti i ligjbërësve të mos imponohet nëpërmjet një ligji të thjeshtë.

Çështjet e tjera lidhen me shpenzimet financiare në momentin kur depozitohet një nismë. Në fakt, kjo është edhe një çështje kushtetuese, sepse Kushtetuta e përcakton qartë se çdo nismë që vjen si vullnet i 20 mijë zgjedhësve, pra që nuk vjen nga Këshilli i Ministrave ose nga deputetët, duhet të ketë patjetër një raport financiar të qartë. Kjo bëhet me qëllim për të bërë transparent burimin e financimit, por edhe për të matur kostot dhe impaktin që mund të ketë një projektligj në aspektin financiar.

Pa u zgjatur, unë dua të vlerësoj edhe cilësinë e nënshkrueses së kësaj nisme, por besoj se edhe kolegu Gjiknuri, që është relatori i saj dhe që ka shumë përvojë në çështjet që lidhen me reformën zgjedhore dhe me referendumet, qofshin ato të përgjithshme apo vendore, si dhe me nismat e qytetarëve, të marrim sa më shumë *feedback*-e dhe të kemi sa më shumë opinione dhe sugjerime konkrete, me qëllim që të procedojmë, sepse ligji ka relativisht një kohë të gjatë që është depozituar në Kuvend, që nga muaji maj i vitit 2018.

Unë ju falënderoj shumë të gjithëve që keni qenë pjesë e grupit të punës dhe që keni dhënë mendime dhe opinione! Kjo do të jetë tryeza e fundit e konsultimit publik, sepse u bë gati një vit që po e diskutojmë. Prandaj, unë i vlerësoj shumë të gjitha mendimet dhe sugjerimet e shpeshuara, por do t'ju sugjeroja që t'i dërgonit edhe në formë të shkruar, me qëllim që ne ta kemi më të thjeshtë për t'i reflektuar.

Gjithashtu, dua të ftoj edhe përfaqësuesit e organizatave të tjera të zënë vendet, si dhe përfaqësuesit e tjerë që janë vëzhgues.

Faleminderit!

Damian Gjiknuri – Nuk dua të zgjatem shumë, por ju falënderoj që erdhët dhe që keni mundësi të kontribuoni për këtë nismë kaq të rëndësishme!

Zonja Hysi e paraqiti shumë mirë ekspozenë e kësaj nisme dhe unë nuk dua të përsëris të njëjtat gjëra, por dua vetëm, për ekonomi kohe, të fokusohemi te varianti i ri që është bërë nga komisioni, sepse, në fund të fundit, ai reflekton edhe opinionin e Komisionit të Venecies,

por edhe një teknikë më të mirë legislative. Kështu që të mos u kthehemi gjërave që presupozohet se janë të kaluara, por le të fokusohemi te disa pika, në mënyrë që këtë nismë ta kalojmë shpejt në komision dhe më pas në seancë plenare. Kështu, duke bërë si fillim një prezantim, është momenti që secili të japë komentet dhe sugjerimet e tij.

Vasilika Hysi – Po, zonja Anastasi.

Aurela Anastasi – Faleminderit, zonjë Vasilika!

Në radhë të parë, unë falënderoj dy nismëtarët për mbështetjen që na kanë dhënë për këtë projektligj, duke e propozuar ju në emrin tuaj para Kuvendit! Faleminderit, zoti Gjikhuri!

Ajo që unë dua të theksoj, pas ekspozesë shumë të qartë që zonja Hysi bëri, është fakti se dy kërkesat kryesore të Komisionit të Venecies, sipas mendimit tim, ishin: së pari, ne kishim parashikuar që të lehtësonim procedurat për qytetarët, duke e zyrtarizuar nismën që në fillim. Pra, ne donim t'i jepnim një pamje zyrtare me qëllim që të mos u nënshtroheshim medoemos kontrolleve në laboratorin e kriminalistikës apo kontrolleve fizike të firmave, që do të sillnin vonesa apo rrëzimin e nismave. Në fakt, Komisioni i Venecies është shprehur se kjo gjë do të kryhej dhe se ne do të lehtësoheshim, duke mos bërë regjistrime paraprake, pranë organit përkatës, duke ndjekur edhe përvojat e ligjeve të tjera të ngjashme, të cilat lidhen me nismat ligjvënëse popullore që ne i kishim drejtuar te KQZ-ja. Pra, ne tashmë nuk do t'i drejtohem më KQZ-së për të zyrtarizuar nismën tonë dhe për të marrë formularët, sikurse ka ndodhur me nismat tona të referendumeve, por do t'i drejtohem në fund, kur t'i kemi mbledhur të gjitha nismat. Kjo është një përgjegjësi për nismëtarët, përgjegjësi për shoqërinë civile dhe për grupet e interesit, pra për qytetarët të cilët kanë marrë nismën.

Së dyti, një nga vërejtjet kryesore të Komisionit të Venecies ishte ndarja e mirë dhe e qartë ndërmjet nismës së 20 mijë zgjedhësve, në bazë të Kushtetutës, nga peticioni. Zonja Vasilika e përmendi pak këtë dhe unë doja ta sqaroja më shumë se ku qëndron problemi te ne. Ne kishim parashikuar që jo vetëm nisma e ligjvënëse apo e 20 mijë zgjedhësve nëpërmjet paraqitjes së një drafti të plotë, përfshirë edhe raportin financiar, do të duhej për zbatimin e këtij ligji, por e kishim parashikuar edhe nëpërmjet paraqitjes së një drafti paraprak, me qëllim që edhe idetë kryesore të qytetarëve t'u ngarkoheshin përfaqësuesve të nismës dhe Kuvendit ta zbardhnin me një ligj në bazë të rregullave të teknikës legislative.

Komisioni i Venecies nuk e pranoi këtë opsion, sepse mendoi se mund të na përziheshin nismat ligjore të 20 mijë zgjedhësve me peticionet. Disa sugjerime të tjera ishin të nivelit teknik, të cilat, së bashku me grupin e punës, jemi përpjekur t'i kemi parasysh, duke i reflektuar në korrigjimet që kemi bërë. Këto korrigjime i janë përcjellë Kuvendit me një tabelë, ku shihet projektligji si ka qenë, si është bërë dhe mbi çfarë baze është ndërhyrë. Meqenëse na

u dha mundësia dhe koha ka qenë e gjatë ne, si grup pune, kemi bërë ndërhyrje dhe korrigjime. Pra, ne kemi ndërhyrë aty ku kemi konstatuar se mund ta përmirësonim më mirë nga ana teknike një nen të caktuar.

Unë dua të sqaroj edhe diçka tjetër. Komisioni i Venecies, në takimet që ne bërë, është shprehur për thjeshtimin e procedurave. Pra, ligji është ndërtuar qartë në mënyrë procedurale, por Komisioni i Venecies kërkoi një thjeshtim të këtyre procedurave. Ky thjeshtim i procedurave është realizuar, sipas mendimit tonë, në dy aspekte: aspekti i parë është ai që unë sapo përmenda, që ne tashmë nuk kemi më nevojë të marrim formularë, sepse ne këtë kishim parashikuar, marrjen e formularëve, regjistrimin e grupit nismëtar, por nuk do ta bëjmë më as këtë. Për hir të së vërtetës, ky ishte propozimi i ODIHR-it, i cili është shprehur se nga përvoja që ai ka pasur në vende të tjera rezultonte se një procedurë e thjeshtuar është më mirë në favor të qytetarëve. Kështu që tani ne nuk shkojmë më paraprakisht në KQZ, por do të shkojmë kur t'i kemi gati të gjithë emrat e qytetarëve, firmat e tyre dhe numrat e tyre të kartës së identitetit.

Procedura tjetër ishte hapja e më shumë vendeve të mbledhjes së firmave. Ne kishim shënuar që vendet e mbledhjes së firmave t'i miratonte këshilli bashkiak ose bashkia. Këtë do ta bënim me qëllim që të ndiheshim kudo të zyrtarizuar, që në momentin që fillonte një nismë, ajo të kishte karakter kushtetues dhe të ishte e mbrojtur nga Kushtetuta. Ata menduan se më mirë do të ishte që të lireshin më shumë hapësira, me shumë liri dhe kërkuan që të shtrihemi jo vetëm në ambientet publike, por edhe private. Kjo gjë nuk na pengon neve që t'i kërkojmë bashkisë leje edhe për ambiente të tjera private, përveç ambienteve private që mund t'i siguronim vetë.

Unë jam këtu për çdo vërejtje apo sugjerim që mund të keni, me qëllim përmirësimin më shumë të këtij projektligji.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Ju lutem, sipas teknologjisë së re, kur flet njëri nga të ftuarit ose ne, nuk duhet shtypur butoni sepse ndërpritet regjistrimi!

Eriona Canaj – Përshëndetje!

Unë jam Eriona Canaj dhe jam komisionere për të drejtat e njeriut në institucionin e Avokatit të Popullit, në seksionin e administratës publike.

Shkurtimisht dua t'ju falënderoj edhe pse koha e vënë në dispozicion është e shkurtër, sepse na janë dhënë vetëm dy apo tri ditë kohë që të studionim materialin. Personalisht e kam parë me kujdes si projektligjin fillestar, ashtu edhe relacionin që ka ardhur nga Komisioni i Venecies së bashku me propozimet për ndryshime. Ndoshta tani është pak vonë për të folur, sepse unë po marr pjesë për herë të parë në këtë tryezë, por nëse ju e shikoni të arsyeshme, dua

të them se ne kemi dy propozime: propozimi parë është me karakter parimor dhe propozimi i dytë lidhet me disa dispozita të veçanta, për të cilat gjykojmë se mund të japim rekomandime për t'i përmirësuar.

Parimisht te pjesa e vendeve publike dhe private, ku ju keni bërë ndryshime, kam konstatuar se këto ndryshime janë bërë në sajë të rekomandimit të Komisionit të Venecies. Ne kemi hasur disa probleme, që lidhen me çështjen e adresave ose të regjistrimit të pronave në vendet ku efektivisht këto zona janë problematike. Kështu që edhe kjo çështje duhet të rishihet dhe duhet të gjejmë mekanizmat për të rregulluar këtë pjesë. Pra, në këtë drejtim ne rekomandojmë që ta trajtojmë edhe këtë pjesë, sepse biem dakord që nuk ka probleme për vendet publike, por ndërkohë për përcaktimin e vendeve private nuk duhet të marrim gjithmonë në konsideratë vetëm Tiranën, Durrësin që ka përfunduar procesi, por jemi në rrugë të mbarë. Duhet të shikojmë edhe ato qytete dhe fshatra, ku kemi probleme me adresat dhe me përcaktimin e saktë të regjistrimit të pronave.

Kemi edhe një element tjetër siç është çështja e publikimit të listës pas verifikimit nga KQZ-ja. Në këtë nismë ligjvënëse, ky është një element që mund të intimidojë deri diku individin, me publikimin e emrit të tij në faqen *online* të paracaktuar, për shkak se mund të ndodhet në marrëdhënie pune, në administratë ose në situata të tjera. Në këtë këndvështrim rekomandojmë mos publikimin e listës së plotë, por të shikojmë mekanizma të tjerë për ta rregulluar këtë çështje, me qëllim mos intimidimin e qytetarëve.

Për fat të mirë ne jemi në prezencë të legjislacionit dhe të praktikave të mira jo vetëm të Bashkimit Europian, por edhe më gjerë, prandaj duhet të shikojmë se çfarë nuk funksionon ose t'u paraprijmë gjërave që mund të mos funksionojnë. Një nga elementet që ka rëndësi në gjykimin tonë është kalimi i projektligjit në rend dite brenda 3 muajve pas depozitimit të tij.

Një nga problematikat e vendeve të Europës Perëndimore është se nisma ligjvënëse në shumë raste nuk përfundon me sukses, sepse ka shumë propozime. Nuk ka lidhje fare me procesin në vetvete, sepse ligji mund të jetë i detajuar, por është procesi i tillë, i cili mund të paraqesë problematika që nga fillimi deri në fund. Në këtë drejtim, në momentin e depozitimit të listës në Kuvend, rekomandojmë që të vendoset një mekanizëm shtrëngues, pra një dispozitë, ku në çdo rast projektligji duhet të diskutohet të paktën në parim, përderisa është një shqetësim i komunitetit. Unë mendoj se kjo është një gjetje, ku çështjen ta diskutojmë në parim në Komisionin e Ligjeve. Përderisa disa vende nuk kanë arritur të ndërhyjnë në pjesën postdepozitimit, atëherë ne këtë gjë mund ta parashikojmë. Ky është një mendim personal që mund ta diskutojmë, të paktën për ta përforcuar pak më shumë, sepse në të vërtetë referendumi, nisma ligjvënëse dhe peticioni janë elemente të një demokracie të drejtpërdrejtë, janë procese

delikate dhe janë nisma, të cilat jo gjithmonë përfundojnë me sukses. Për shembull, mund të kemi 300 nisma, por vetëm 3 prej tyre mund të përfundojë me sukses. Pra, miratimi ose jo i projektligjit është një çështje tjetër, të paktën të diskutohet në parlament.

Edhe nga pikëpamja legislative kisha dy-tri elemente, për sa i takon pjesës së parimeve bazë. Unë i referohem efektivisht nenit 2 ku saktësohet: “Ndalohej çdo lloj kufizimi në procesin e propozimit të projektligjeve, bazuar në shkaqe të e tilla si gjinia, raca, gjuha, besimi fetar, bindjet politike apo bindje të tjera, origjina kombëtare ose sociale...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, teknikë legislative e mirëfilltë, po për riformulimin e parimeve bazë.

Damian Gjiknuri – Riformuloje si të duash, por, kur vjen puna për riformulim, është më mirë të jenë me shkrim dhe ne e kemi më të qartë se si do të ndërhyhet.

Specialiste – Dakord. Propozimet e tjera ishin me karakter riformulimi për dispozita të veçanta. Por, ju lutem, na jepni disa ditë kohë t’i formulojmë qartë dhe do të dërgohen nga ana e institucionit.

Faleminderit!

Damian Gjiknuri – Po, zoti Gajda.

Robert Gajda – Unë jam komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Meqenëse jemi te neni 2, kisha dy propozime. Së pari, termi “paaftësi fizike” duhet hequr kategorikisht, sepse ka kohë që është ezauruar.

E dyta, ndoshta nuk është mirë të listohen shkaqet e diskriminimit, por të referohet ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Duke i listuar në mënyra të ndryshme, krijohet idea që për ligje të veçanta do të duhet të fokusohen shkaqe të veçanta, prandaj duhet ta standardizojmë aspektin e referimeve. Kjo është më e përgjithshme, pra, kur bëhet fjalë për diskriminimin, të referohet ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Faleminderit!

Damian Gjiknuri – Po, zoti Dervishi.

Besnik Dervishi – Në cilësinë e komisionerit “Për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale”, pavarësisht kohës së shkurtër, ne e kemi studiuar ligjin me shumë vëmendje. Kjo është një nismë pozitive, e cila plotëson një boshllëk të deritanishëm.

Ne kemi disa sugjerime në lidhje me plotësimin e legjislacionit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Duke qenë se procedura mban elemente të të dhënave personale, sugjerojmë që: për një pjesë e parimeve bazë të këtij projektligji të bëhet edhe garantimi i të dhënave personale. Për këtë arsye ne kemi bërë një riformulim që mbas pikës 2, të nenit 2, të shtohet një pikë 3 me përmbajtje, të cilën do ta depozitojmë pranë komisionit.

Gjithashtu, në nenin 10 të projektligjit parashikohet një informacion që duhet të përmbajë fleta e mbledhjes së nënshkrimeve, si gjeneralitetet e zgjedhësve që mbështesin nismën, datën e lindjes, numrin e kartës së identitetit, numrin e pasaportës së zgjedhësve e të tjera. Informacioni që përmban fleta duhet të jetë publik, por, pasi fleta të plotësohet, disa informacione nuk duhen bërë publike, sepse cenojnë të dhënat personale të shtetasve dhe duhet pasur kujdes.

Nuk duhet të ndodhë ajo që ka ndodhur me formularët e dekriminalizimit, ku bëhen publike edhe numrat e kartës së identitetit, për këtë ne kemi njoftuar Kuvendin dhe shumë shpejt duhet bërë ndërhyrja. Personat e kanë detyrim plotësimin e numrit të kartës së identitetit në formularin e dekriminalizimit, por nuk ka asnjë arsye që të bëhet publike, sepse është jashtë qëllimit të vetë ligjit. Të njëjtën gjë duhet të kemi parasysh edhe në këtë projektligj, prandaj e mora si shembull.

Një element tjetër që duhet pasur parasysh në këtë projekt ka të bëjë me parimet themelore të mbrojtjes së të dhënave. Të dhënat e regjistruara duhet të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur, nuk mund të përdoren për qëllime të tjera. Kjo mund të realizohet nëpërmjet një shënimi në formularët ku do të hidhen firmat e shtetasve.

Faleminderit për mundësinë! Uroj që ky ligj të miratohet sa më shpejt.

Damian Gjiknuri – Faleminderit!

Sugjerimet tuaja bëjnë sens dhe besoj se do të merren parasysh.

Po, zonjë.

Shpresa Peza – Unë jam përfaqësuese e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Për arsye të koordinimit tonë të brendshëm, nuk jemi vënë në dijeni me tekstin e projektligjit. Ne e vlerësojmë këtë iniciativë, sepse do të vendosë në shina një nismë shumë të rëndësishme.

Sapo të kemi një opinion në lidhje me projektin, do t’jua përcjellim me *email* ose në forma të tjera të komunikimit.

Damian Gjiknuri – Po.

Deshira Pasko – Ne kemi bashkëpunuar në hartimin e ligjit. Në punën tonë kemi synuar të kishte një unifikim të të gjitha procedurave që janë në lidhje me propozimin, siç janë nisma për referendume, nisma ligjvënëse, regjistrimet e komiteteve, nismëtari për regjistrim e të tjera. Pra, qëllimi bazë ka qenë që të kishte një unifikim të të gjitha procedurave.

Me thjeshtimin e procedurave, KQZ-ja ka më pak kompetenca, por jo të parëndësishme. Është hequr kompetenca e regjistrimit të nismës për referendumin, për regjistrimin e partive dhe kandidatëve.

Në disa dispozita ne i jemi referuar Kodit Zgjedhor, në mënyrë që të mos kemi përsëritje të rregullave të njëjta, që janë në ligje të ndryshme.

KQZ-ja është e familjarizuar me këto procedura, prandaj mund ta administrojë dhe ta vë nënkontroll.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri – Po, Eno.

Enio Haxhimihali – Unë kam një sugjerim, për atë pjesë që foli edhe përfaqësuesja e KQZ-së, por nuk di nëse mund të shikohet me interes si nga Kuvendi dhe nga KQZ-ja. Projektligji parashikon hapjen e një faqe interneti. Pra nismën ligjvënëse e kanë INGO-të, por edhe individët, por duhet të kemi parasysh që INGO-të mund ta kenë faqen e tyre, por ato duhet të shkojnë te AKEP-i të marrin leje që të hapin faqen. A mundet që KQZ-ja t'i postojë përkohësisht në faqen e tyre? Pra për të reduktuar kostot dhe procedurat e qytetarëve, KQZ-ja të hapë një dritare në faqe që ta përdorin ata.

Damian Gjikhuri – A keni ndonjë propozim konkret se si mund të formulohet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, ideja është që të lehtësohet kjo procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mendojeni, shikoni edhe ndonjë përvojë të ngjashme dhe besoj se do të jetë me vlerë që të vijë ky sugjerim.

Vasilika Hysi – A ka ndonjë përvojë në këtë propozim, sepse nëse futet mund të jetë një nismë që mund të komprometojë faqen zyrtare të KQZ-ë? Pra varet se çfarë nisme është.

Enio Haxhimihali – Teknikisht kjo gjë mund të realizohet, pra të krijohet eksesi dhe shpenzimet të mbulohen nga dikush tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përmbajtja do të zgjidhet me aktin ligjor.

Damian Gjikhuri – Eno, shikoni çfarë vështirësish ka aktualisht, sepse ashtu siç është shkruar, bëhet e pamundur apo e vështirë. Kjo bëhet për të na ndihmuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mendime të tjera? A ka ndonjë kundërshti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë ezauruar të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të vazhduar më tej me procedurën, për të gjitha propozimet do të lëmë një afat deri në datën 2 prill, që të vijë me shkrim. Pra, ky është afati fundit për të administruar të

gjitha propozimet tuaja, pastaj do të bëjmë edhe rikonceptimin e fundit me grupin e punës në mënyrë që nisma të shqyrtohet në komision.

A jeni dakord? A ka ndonjë koment nga anëtarët e tjerë të komisionit? Nuk ka.

Faleminderit për kontributin dhe ju mirëpresim!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA